

BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. 13195 / prot.

Tiranë 4. 4 2025

URDHËR

Nr. 105, datë 04. 4 2025

**“PËR
CAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE RREGULLAT PËR AFISHIMIN
E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, si dhe në vijim të memos nr. 13195, datë 04.04.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Brendshëm,

URDHËROJ

1. Pranë zyrave dhe ambjenteve të çdo njësie administrative/ lagjeve të Bashkisë Tiranë, kryhet afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor.
2. Njësitë Administrative/Lagjet përcaktojnë vendet e lejuara për afishimin e materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore.
3. Materialet propagandistike zgjedhore të afishohen deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
4. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore të marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
5. Pas marrjes së informacionit nga subjektet zgjedhore për adresat e sakta të zyrave elektorale, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm, në Koordinimin me Njësitë Administrative/ Lagjet, brenda 5 ditëve të bëjë verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të sigurohet për respektimin e dispozitave të udhëzimit nr. 6, 23.03.2021, të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve, për afishimin e materialeve propagandistike.
6. Policia Bashkiake të marrë masa të menjëhershme për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të afishuara në kundërshtim me këtë urdhër dhe kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit me Qytetarët për publikimin e këtij urdhëri në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Brendshëm, Njësitë Administrative/ Lagjet e Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit me Qytetarët dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Anuela Ristani

